

## VENDIM

Nr.650, datë 14.9.2011

### PËR LICENCIMIN E AKADEMISË SË STUDIMEVE TË APLIKUARA "REALD"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2,43,44 e 45, të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Licencimin e akademisë së studimeve të aplikuara "REALD", e cila do ta ushtrojë veprimtarinë e saj në qytetin e Vlorës.
  2. Akademia e studimeve të aplikuara "Reald" do të organizohet në dy fakultete:
    - a) Fakultetin e Shkencave Mjekësore, që do të ofrojë programin e studimit të ciklit të parë në "Infermieri", si dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë në: i) Stomatologji; ii) Farmaci.
    - b) Fakultetin e Ekonomisë që do të ofrojë programet e studimit të ciklit të parë në: i) Marketing; ii) Financë; iii) Menaxhim.
  3. Akademia e studimeve të aplikuara "REALD" do të ofrojë programe studimi të ciklit të parë, në "Infermieri", "Marketing", "Financë", "Menaxhim", që do të realizohen me 180 kredite dhe me kohëzgjatje normale 3 (tri) vite akademike. Në përfundim të këtyre programeve të studimit do të lëshohet diplomë universitare "Bachelor", përkatësisht në:
    - a) Infermieri;
    - b) Marketing;
    - c) Financë;
    - ç) Menaxhim.
  4. Akademia e studimeve të aplikuara "REALD" do të ofrojë programe të integruara të studimeve të ciklit të dytë në "Stomatologji" dhe "Farmaci", që do të realizohen me 300 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 5 (pesë) vite akademike. Në përfundim të këtyre programeve të studimit do të lëshohet diplomë universitare "Master i shkencave", përkatësisht në:
    - a) Stomatologji;
    - b) Farmaci.
  5. Akademia e studimeve të aplikuara "REALD" ta fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimeve, të përcaktuara në pikën 2, të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se tri javë para fillimit të vitit të ri akademik, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.
  6. Ndryshimet në vendndodhje, plane, forma studimi dhe programe, si dhe në elemente të tjera të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.
  7. Akademia e studimeve të aplikuara "REALD", Vlorë, duhet t'i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe të programeve të studimeve, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.
  8. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi dhe për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha